



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Nr./Br.

611-612/20

Datë/Datum.

08.10.20

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PRISHTINË - PRIŠTINA

PSH .nr. 611/20
612/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Rahovica Company” SHPK-Ferizaj si dhe OE “Kema Company” SHPK-Lipjan, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: GOE “Kosova Asfalt” SHPK “Agim Morina B” SHPK, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës nga Flotacioni lagja Vakovc” me nr. të prokurimit: 616-20-1262-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë, më datën: 08.10.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Rahovica Company” SHPK- Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës nga Flotacioni lagja Vakovc” me nr. të prokurimit: 616-20-1262-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë.

II. APROVOHET, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Kema Company” SHPK-Lipjan, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës nga Flotacioni lagja Vakovc” me nr. të prokurimit: 616-20-1262-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë.

III. ANULOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës nga Flotacioni lagja Vakovc” me nr. të prokurimit: 616-20-1262-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

IV. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

V. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

VI. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Rahovica Company”SHPK- Ferizaj, aprovohet si e bazuar, **Ndërsa** ankesat e operatorit ekonomik ankues “Kema Company”SHPK-Lipjan aprovohet si pjesërisht e bazuar, iu bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtimit të ankesës.

VII .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE “Rahovica Company”SHPK- Ferizaj, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 31.08.2020 me nr. 611/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës nga Flotacioni lagja Vakovc” me nr. të prokurimit: 616-20-1262-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë , duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet; 1, 6, 7, 59, 61, 65, si dhe 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës dhe nenin 39 të RRUOPP-së

Operatori ekonomik ankues OE “Kema Company”SHPK-Lipjan, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 31.08.2020 me nr. 612/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i rrugës nga Flotacioni lagja Vakovc” me nr. të prokurimit: 616-20-1262-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 63, paragrafi 3 si dhe nenin 69 paragrafi 4, të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 09.09.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Ekspertja shqyrtuese e prokurimit në raportin e dt: 21.09.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim:

Sa i përket vlerësimit të pretendimeve të OE ankuesit “Rahovica Company”SHPK:

AK ne kërkesën për rishqyrtim na i ka hudhur tri pretendimet ankimore.

Kjo është shume e lehte për tu vërtetuar sepse AK nuk e ka shqyrtuar siç duhet rastin por me tepër ka mbrojtur OE, se sa ka paraqitur realitetin, si te punëtorët (latuesit dhe armiruesit), si te Deklarata nen Betim, Si te Çmimi jo normalisht i ulet, etj.

Pretendimi nr. 1.

AK ka shkelur nenin 7 dhe nenin 59 te LPP-se, duke e shpallur me kontrate një OE te papërgjegjshëm, pasi qe OE nuk i plotëson kriteret e kërkuara te FDT-se dhe NJK-se, pasi qe nuk e plotëson kriterin e kërkuar: 5 armirues & 5 latues te certifikuar.

Por, OE i rekomanduar nuk e plotëson kriterin e kërkuar pasi qe nuk i ka për fushën përkatëse, por i ka për siguri dhe shëndet ne pune te lëshuar nga Trupa Cetifikuese NMA, ku e dijm se kjo trupe certifikuese i licencon kompanitë për Siguri dhe shëndet ne pune, dhe nuk i Certifikon për Latues/armirues.

Kriteri i kërkuar i AK-së:

Kërkesa: -Operatori ekonomike duhet te ofroj dëshmi për min. 30 punëtor ne stafin e tij, prej tyre min. 5 latues te certifikuar dhe min. 5 armirues te certifikuar me përvojë pune minimum tri vite.

Dëshmia: Kopjet e certifikatave, CV, kontrata e punës ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë Project. Pra, pasi qe kërkesa e AK-se ka qene “min. 5 latues te certifikuar dhe min. 5 armirueste certifikuar me përvojë pune minimum tri vite”. Por OE i rekomanduar nuk i ka 5 latues te certifikuar, por i ka 5 latues te trajnuar per siguri dhe shëndet ne pune sipas Ligjit nr. 04/161, neni 9.1 i këtij Ligji, qe nuk përkon fare me kriterin e kërkuar.Pra, ne këtë pike OE i rekomanduar është i papërgjegjshëm pasi qe nuk e plotëson kriterin e AK-se si ne FDT dhe NJK, dhe AK ka shkelur nenin 59.4 te LPP-se, pasi qe nuk është OE i përgjegjshëm nje OE qe nuk e përmbush kriterin e kerkuar te AK-se (si ne fdt dhe njk).

Pra, edhe pse nuk e plotëson kriterin e kërkuar ne FDT dhe NJK, për 5 latues & 5armirues, Punëtorët e trajnuar për siguri dhe shëndet ne pune dhe absolutisht nuk e plotëson kriterin e kërkuar te AK-se (3 vite përvojë pune) te cilët kane kryer trajnimin me dt. 11.05.2020 për Siguri dhe Shëndet ne Pune, qe nënkuptohet se as një muaj përvojë me datën e aplikimit dhe kërkesa ka qene 3 vite.

Përgjigja e AK-së në kërkesë për rishqyrtim në këtë pretendim:

Pretendimi juaj lidhur me certifikatat për latues dhe armirues është i pa bazuar, pasi qe Autoriteti Kontraktues nuk ka pas asnjë kërkesë decidive se nga kush duhet te jene te lëshuara te njëjtat dhe për ne çfarëdo licence apo certifikate qe e dëshmon atë kualifikim për AK-ne është e pranueshme;

Eksperti Shqyrtues pretendimin e OE ankuesit e gjenë të bazuar, me arsyetimin se AK në Njoftimin për kontratë

tek kërkesa III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional NJK kërkon:

-Operatori ekonomike duhet te ofroj dëshmi për min. 30 punëtor ne stafin e tij, prej tyre min. 5 latues te certifikuar dhe min. 5 armirues te certifikuar me përvoje pune minimum tri vite.

Eksperti Shqyrtues pas verifikimit dhe analizimit të Aktivitetit sqaron se në ofertën e OE të rekomanduarit figurojnë vetëm certifikatat për pjesëmarrje në trajnim me datën 11.05.2020, i mbajtur nga **NMA SHPK**, kompani e licencuar për Siguri dhe Shëndet në Punë. Pra Armiruesit dhe Latuesit nuk kanë të bashkangjitur Certifikatat që vërtetojnë se janë Latues/Armirues të Certifikuar.

Në këto raste AK gjatë vlerësimit dhe ekzaminimit të ofertave, sipas nenit 72 të LPP-së është dashur të kërkojë informata shtesë lidhur me këto Certifikata.

Mungon Certifikata e numrit fiskal	Mund te kërkohe informata sqaruese	66	
Mungon licenca	Mund te kërkohe informata sqaruese	66	
Mungon certifikata ISO	Mund te kërkohe informata sqaruese	69	

Pretendimi 2 i OE ankuesit:

Deklarata nen betim nuk e plotëson kriterin sipas nenit 65 te LPP-se, pasi qe deklarata nen betim duhet te jete e nënshkruar nga pronari i kompanisë ne këtë rast nënshkrimi është nga pronari, kurse personi i shënuar ne deklarate nen betim nuk është pronar as drejtor i kompanisë dhe as nuk posedon autorizim ne dosjen e tenderit, po ashtu vlen te ceket se i njëjti person i shënuar ne deklaratën nen betim Bujar Shabani është pronar i kompanisë Bageri e cila është ofertues ne këtë procedure, ku kemi te bëjmë me personin e njëjtë i cili ka ofertuar dy here me kompani te ndryshme.

Ky veprim e bën ofertën te papërgjegjshme sipas nenit 65 te LPP-se dhe nenit 39 te RrUOPP-se.

Po ashtu ne lidhje me këtë ka interpretim te lëshuar nga KRPP nëse dikush nënshkruan ne emër te dikujt tjetër pa autorizim.

Po e bashkangjesim interpretimin nr. 40 te KRPP-se.

40. Si të vepohet në rastet kur dosja e tenderit, përfshirë deklaratat nën betim dhe dokumentet tjera të dosjes së tenderit nënshkruhen në emër të Operatorit Ekonomik ofertues, nga një person i pa autorizuar ?

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.7 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, sa i përket çështjes së parashtruar më lartë, KRPP ofron interpretim ligjor si në vijim:

Të drejtën e nënshkrimit nga një person në emër të një personi tjetër në dosjen e tenderit dhe deklaratat nën betim pa një autorizim nga personi kompetent, nuk e rregullon Ligji për Prokurimin Publik dhe as legjislacioni dytësor i Prokurimit Publik. Megjithatë, për deri sa në Formularët standard të Dosjes së Tenderit përfshirë deklaratën nën betim dhe dokumentet tjera, kërkohen të dhënat mbi identifikimin e OE, (siç janë: Emri dhe mbiemri, pozita nënshkrimi, data, vula etj) pra kërkohet të plotësohen dhe të nënshkruhen nga përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik (dhe jo nga një person që nuk është kompetent dhe nuk ka autorizim për ta bërë një gjë të tillë). KRPP, konsideron se, nënshkrimi " për" në emër të përfaqësuesit të OE nga një person që nuk ka autorizim për një gjë të tillë, nuk mund të jetë i pranueshëm.

Përgjigja e Ak-së në kërkesë për rishqyrtim në këtë pretendim:

Edhe pretendimi vijues është i pa bazuar pasi që personi që ka nënshkruar dokumentacionin është pronar i kompanisë dhe vetëm emri është shënuar sigurisht gabim, pasi që e dini edhe ju që kemi të bëjmë me anëtar të familjes së njëjtë ("Bageri" dhe "Kosova Asfalt"). Ne deklarojmë qartë se nënshkrimi është i Valdrin Shabanit, i cili në çertifikatën e regjistrimit të biznesit është i paraqitur pronar i kompanisë.

Eksperti Shqyrtues pretendimin e OE ankuesit e gjënë të bazuar me faktin se Deklarata nën betim duhet të jetë e qartë, me të gjitha informatat e sakta në mënyrë që të saktësohet nënshkruesi, për deri sa në Formularët standard të Dosjes së Tenderit përfshirë deklaratën nën betim dhe dokumentet tjera, kërkohen të dhënat mbi identifikimin e OE, (siç janë: Emri dhe mbiemri, pozita nënshkrimi, data, vula etj) pra kërkohet të plotësohen dhe të nënshkruhen nga përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik.

Eksperti Shqyrtues sqaron se, sa i përket Pyetjes në Krpp, aty bëhet fjalë për nënshkrimin, pra Deklarata e nënshkruar nga personi i pa autorizuar ose nënshkrimi PËR. Gjersa në rastin konkret Deklarata nën Betim është gabuar tek Emri ndërsa nënshkrimi është në rregull, por që edhe nga KRPP sqarohet se Deklarata nën betim duhet të jetë e kompletuar ashtu si kërkohet, për deri sa në Formularët standard të Dosjes së Tenderit përfshirë deklaratën nën betim dhe dokumentet tjera, kërkohen të dhënat mbi identifikimin e OE, (siç janë: Emri dhe mbiemri, pozita nënshkrimi, data, vula etj) pra kërkohet të plotësohen dhe të nënshkruhen nga përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik (dhe jo nga një person që nuk është kompetent dhe nuk ka autorizim për ta bërë një gjë të tillë). KRPP, konsideron se, nënshkrimi " për" në emër të përfaqësuesit të OE nga një person që nuk ka autorizim për një gjë të tillë, nuk mund të jetë i pranueshëm.

Pretendimi 3 i OE ankuesit:

AK po ashtu ka shkelur nenin 61 (Tenderit jo-normalisht të ulëta) te LPP-se, sepse e njëjta procedure e tenderimit ka qene e kontraktuar me një OE i cili ka dështuar te përfundoj kontratën me sukses për shkak te çmimeve jo normalisht te ulëta, dhe ka ndërpre kontratën dhe përsëri AK ne projektin e njëjtë e shpërblen një OE me çmime jo normalisht te ulëta.

OE Kosova Asfalt ka çmime jo normalisht te ulët te Pahite elastike, ku ky OE ka ofertuar me çmim 9.00 € për metër te pahive, kurse ne kemi ofertuar me çmim 15.00 € pa TVSH, ku dihet se çmimi i një metri pahi elastike është 15.00 €, kurse OE ka ofertuar 9.00 € nen çmim te furnizimit, dhe ky çmim Llogaritet si jo-normalisht i ulet sipas nenit 61 te LPP-se.

Neni 61 - Tenderët Jo-Normalisht të Ulët

1. Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elemente vepër bërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafin 2.të këtij neni.

2. Gjatë përcaktimit nëse një tender është apo duket të jetë jo-normalisht i ulët,autoriteti kontraktues do të merr parasysh shpjegimet e dorëzuara nga tenderuesi në lidhje me:

2.1 .ekonominë e procesit të prodhimitarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit;

2.2. çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur;

2.3. çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose

2.4. origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

Pra, AK për çmimet jo-normalisht te ulëta te ofertuar nga OE ankues, duhet te kërkoj sqarime sipas paragrafi 2 te nenit 61 te LPP-së.

Përgjigja e Ak-së në kërkesë për rishqyrtim në këtë pretendim:

-Pretendimi tjetër lidhur me çmimet jo normalisht te ultë është i pa bazuar, pasi qe AK-ja bazuar ne dispozitat ligjore ka kërkuar sqarime shtese nga tenderuesit te cilët sipas atyre rregullave janë konsideruar me çmim jo normalisht te ulet dhe këto sqarime janë kërkuar edhe nga tenderuesi i propozuar për dhënie te kontratës,

Eksperti Shqyrtues që jetë sa më objektiv ka analizuar ofertat e të gjithë pjesëmarrësve/Çmimet për këtë

pozicion dhe sqaron se çmimet sillen nga 13,15,16,17,18,20, 21,21,23 ndërsa çmimi i OE të rekomanduarit është 9 euro, gjersa nëse e marrim një mesatare të këtyre çmimeve del çmimi rreth 17,50 euro.

AK thuajse për të gjitha ofertat ka kërkuar sqarim në lidhje me çmimet të cilat është menduar që janë të ulëta ose të larta, dhe në rastin konkret për këtë pozicion nuk ka kërkuar.

Eksperti Shqyrtues konsideron se pretendimi i OE ankuesit gjendet i bazuar.

Sa i përket vlerësimit të pretendimeve të OE ankuesit “KEMA COMPANY”SHPK:

Ne si kompani kërkojmë rivlerësim për këtë vendim për arsye se kemi dorëzuar sqarimin për shume pozicione te cilat janë vlerësuar si çmime jo-normalisht te ulet dhe për te gjitha ato çmime ne kemi deklaruar ofertat nga disa kompani te cilat furnizohemi me materialet e caktuara, gjithashtu vlen te ceket se gjate sqarimit te çmimeve ne kemi deklaruar ofertat nga kompanitë te cilat ne kemi marrëveshje vjetore për furnizim mirëpo përveç atyre ofertave te deklaruar ne posedojmë edhe oferta te tjera për te njëjtat pozicione ku çmimet i kemi te përafërta me një ndryshim mjaft te vogël gjë qe nënkupton se çmimi i ofertuar është çmim brenda tregut, gjithashtu duke u bazuar edhe ne ndryshimet e vogla qe mund te ndodhin gjate kohës ne vijueshmëri.

Nga 10 pozicionet qe kemi pranuar kërkesë për sqarime ne jemi eliminuar duke u bazuar vetëm ne dy pozicione ku pozicioni 3.4 është njeri nga pozicionet qe përfshinë materialin te cilin ne jemi fabrike prodhuese e elementeve te betonit dhe betonit për nevojat e kompanisë pasi qe sasia e kërkuar e betonit ne këtë pozicion ka qen vetëm 25m3 dhe kjo nënkupton se për këtë sasi kompania mund te prodhoj dhe furnizoj gjate punimeve me beton te gatshme nga betonjerka personale ndërsa pozicioni 2.17 është pozicion për te cilin kompania ka deklaruar se ka ne stok një sasi te hekurit prej 10,000kg si dhe ofertat paraprake te pranuar nga disa kompani për këtë pozicion.

Gjithashtu deklarohemi qe kompania është e gatshme qe te pranoj nga Autoriteti Kontraktues rritjen e sigurimit për kryerjen e pozicioneve te caktuar, gjë qe nënkupton qene si kompani jemi dakord qe te shfrytëzohet mundësia me e mire edhe nga AK pra rritja e sigurimit te ekzekutimit ne një vlere te arsyeshme pasi qe janë vetëm dy pozicione te cilat ka dyshime për çmime te ulëta mirëpo nuk e shohim te arsyeshme me vazhdu me eliminim direkt pa ndonjë kërkesë shtesë për te rritur sigurinë dhe besueshmërinë për kryerjen e këtyre pozicioneve.

Përgjigja e Ak-së në kërkesë për rishqyrtim në këtë pretendim:

Pretendimi juaj se tenderi juaj është refuzuar pa te drejte si tender me çmim abnormalisht te ulet është i pa bazuar për faktin se çmimet e dhëna dhe sqarimet tuaja janë vlerësuar ne mënyrë korrekte nga komisioni profesional dhe për çmimet e ofruara ne pozicionet qe ju i përmendni ne kërkesë nuk mund te gjindet asnjë arsyetim. Ajo qe ju thoni se jeni prodhues apo keni marrëveshje furnizimi nuk mund te merren si argumente, pasi qe edhe ju e dini se çdo prodhim ka një kosto reale te tregut dhe po ashtu edhe çdo furnizim,prandaj deklarimet dhe

marrëveshjet fiktive sa për pjesëmarrje në tender nuk mund të jenë arsytim për çmimet e dhëna nga ana juaj. Lidhur me parakushtet për rritjen e sigurisë së ekzekutimit ju sqaroj se kjo mund të aplikohet, por vetëm në rastet kur Autoriteti Kontraktues beson se e njëjta i mbulon detyrat eventuale të shkeljes së kontratës e që në rastin tuaj është konsideruar se rritja e sigurisë nuk e garanton të njëjtën.

Letra standarde e Ak-së për tenderuesin e eliminuar OE : “Kema Company” SHPK Comany Murseli SHPK:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye :

Grup i Operatorëve Ekonomik Kema - Company Sh.p.k.; Company Murseli SH.P.K., pas kërkesës për informata mbi tenderet jo-normalisht të ulët, kanë ofruar përgjigje, disa janë të pranishme pas sqarimeve me shkrim, mirpo për pozicionin 3.4 Rruga (Mbistruktura-betonimi i rigolles), pozicioni 2.17 Ura (punët e betonit-furnizimi dhe punimi i armatures) këto sqarime janë të pa pranueshme, sepse janë çmime abnormalisht të ulta – duke marrë për bazë çmimet e tregut si dhe procedura teknike për realizimin e këtyre pozicioneve, prandaj janë të papërgjegjshëm

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qenë në gjendje t'i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

Prokurimi Prishtinë

Eksperti Shqyrtues pretendimin e OE ankuesit “Kema Company” SHPK e gjenë të pa bazuar, për arsye se AK ka kërkuar sqarime dhe pasi ka marrë sqarimet nga ana e OE ankuesit, ka analizuar arsyetimet dhe ka marrë një vendim sipas dispozitave Ligjore të LPP-së.

Ku Neni 61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulët i LPP-së pika 4: Citat” Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin”.

Pra, Eksperti Shqyrtues pas këtyre procedurave konsideron se është në diskrecion të AK-së çështja e çmimeve.

Ndërsa Pretendimi i dytë i OE ankuesit lidhur me Certifikatat e Latuesit dhe Armiruesit, këtë pretendim **Eksperti Shqyrtues nuk e shqyrton** për arsye se në kërkesën për rishqyrtim tek AK, OE ankuesi nuk e ka, andaj sipas rregullores së Krpp-së pika citat” 9.2 *Ankesa do të dorëzohet në origjinal tek Organi Shqyrtues i Prokurimit “OSHP” dhe njëkohësisht, një kopje e ankesës do t'i dorëzohet Autoritetit Kontraktues.*

Pretendimet ankimore duhet te jene te njëjta me ato te paraqitura ne Autoritetin Kontraktues” andaj si e tillë nuk shqyrtohet.

Eksperti Shqyrtues si konkludim konsideron se Aktiviteti i Prokurimit **“Ndertimi i rruges nga Flotacioni lagja Vakoc”** në bazë të pretendimeve të bazuara të OE ankuesit “Rahovica Company”SHPK duhet të kthehet në rivlerësim, dhe se AK konform dispozitave ligjore të LPP-së të bëj vlerësimin dhe ekzaminimin e ofertave.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankuesit “Rahovica Company”SHPK të aprovohet si e bazuar ndërsa ankesa e OE ankuesit “Kema Company”SHPK të refuzohet si e pa bazuar dhe se vendimi i AK-së të anulohet, ky aktivitet i prokurimit të kthehet në **Rivlerësim**.

Autoriteti Kontraktues nuk është përgjigjur rreth raportit të ekspertizës.

Operatori Ekonomik- “Rahovica Company”SHPK, me datë: 22.09.2020, me anë të parashtrësës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik- “Kema Company”SHPK, nuk është përgjigjur rreth raportit të ekspertizës.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 08.10.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtrësat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për dhënie të kontratës.

Paneli shqyrtues ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues “Rahovica Company”SHPK

Në lidhje me pretendimin ankimor se AK ka shkelur nenin 7 dhe nenin 59 të LPP-se, duke e shpallur me kontratë një OE të papërgjegjshëm, pasi që OE nuk i plotëson kriteret e kërkuara të FDT-se dhe NJK-se, pasi që

nuk e plotëson kriterin e kërkuar- 5 armirues & 5 latues te certifikuar. OE i rekomanduar nuk e plotëson kriterin e kërkuar pasi që nuk i ka për fushën përkatëse, por i ka për siguri dhe shëndet ne pune te lëshuar nga Trupa Cetifikuese NMA, ku e dijm se kjo trupe certifikuese i licencon kompanitë për Siguri dhe shëndet ne pune, dhe nuk i Certifikon për Latues/armirues. OE i rekomanduar nuk i ka 5 latues te certifikuar, por i ka 5 latues te trajnuar për siguri dhe shëndet ne pune sipas Ligjit nr. 04/161, neni 9.1 i këtij Ligji, që nuk përkon fare me kriterin e kërkuar. Pra, ne këtë pike OE i rekomanduar është i papërgjegjshëm pasi që nuk e plotëson kriterin e AK-se si ne FDT dhe NJK, dhe AK ka shkelur nenin 59.4 te LPP-se, pasi që nuk është OE i përgjegjshëm një OE që nuk e përmbush kriterin e kërkuar te AK-se (si ne FDT dhe NJK).

Pra, edhe pse nuk e plotëson kriterin e kërkuar ne FDT dhe NJK, për 5 latues & 5 armirues, Punëtorët e trajnuar për siguri dhe shëndet ne pune dhe absolutisht nuk e plotëson kriterin e kërkuar te AK-se (3 vite përvojë pune) te cilët kane kryer trajnimin me dt. 11.05.2020 për Siguri dhe Shëndet ne Pune, që nënkuptohet se as një muaj përvojë me datën e aplikimit dhe kërkesa ka qene 3 vite.

Paneli shqyrtues sqaron se kërkesa e AK në dosje të tenderit ka qenë: “Operatori ekonomik duhet te ofroj dëshmi për min. 30 punëtor ne stafin e tij, prej tyre min. 5 latues te certifikuar dhe min. 5 armirues te certifikuar me përvojë pune minimum tri vite, ku si dëshmi dokumentare është kërkuar: Kopjet e certifikatave, CV, kontrata e punës ose marrëveshja mbi angazhimin për këtë Project”.

Paneli shqyrtues sqaron se pas analizimit të pretendimit ankimor konform mendimit të ekspertit shqyrtues shihet se në ofertën e OE të rekomanduarit figurojnë vetëm certifikatat për pjesëmarrje në trajnim me datën 11.05.2020, i mbajtur nga NMA SHPK, kompani e licencuar për Siguri dhe Shëndet në Punë. Pra, Armiruesit dhe Latuesit nuk kanë të bashkangjitur Certifikatat që vërtetojnë se janë Latues/Armirues të Certifikuar.

Paneli shqyrtues vlerëson se AK gjatë vlerësimit dhe ekzaminimit të ofertave, sipas nenit 72 të LPP-së është dashur të kërkojë informata shtesë lidhur me këto Certifikata.

Në lidhje me pretendimin ankimor se deklarata nen betim nuk e plotëson kriterin sipas nenit 65 te LPP-se, pasi që deklarata nen betim duhet te jete e nënshkruar nga pronari i kompanisë ne këtë rast nënshkrimi është nga pronari, kurse personi i shënuar ne deklarate nen betim nuk është pronar as drejtor i kompanisë dhe as nuk posedon autorizim ne dosjen e tenderit, po ashtu vlen te ceket se i njëjti person i shënuar ne deklaratën nen betim Bujar Shabani është pronar i kompanisë Bageri e cila është ofertues ne këtë procedure, ku kemi te bëjmë me personin e njëjtë i cili ka ofertuar dy here me kompani te ndryshme. Po ashtu ne lidhje me këtë ka interpretim te lëshuar nga KRPP (nr. 40) nëse dikush nënshkruan ne emër te dikujt tjetër pa autorizim AK gjate rivlerësimit te kërkoj informata shtese konform nenit 59 dhe 72 te LPP-se.

Paneli shqyrtues sqaron se Deklarata nën betim duhet të jetë e qartë, me të gjitha informatat e sakta në mënyrë që të saktësohet nënshkruesi, për deri sa në Formularët standard të Dosjes së Tenderit përfshirë deklaratën nën betim dhe dokumentet tjera, kërkohen të dhënat mbi identifikimin e OE, (siç janë: Emri dhe mbiemri, pozita nënshkrimi, data, vula etj) pra kërkohet të plotësohen dhe të nënshkruhen nga përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik e që në rastin konkret nuk është e qartë, andaj edhe pretendimi ankimor është i qëndrueshem.

Paneli shqyrtues sqaron se sa i përket Pyetjes në KRPP, aty bëhet fjalë për nënshkrimin, pra Deklarata e nënshkruar nga personi i pa autorizuar ose nënshkrimi **PËR**, ndërsa në rastin konkret Deklarata nën Betim është gabuar tek Emri ndërsa nënshkrimi është në rregull, por që edhe nga KRPP sqarohet se Deklarata nën betim duhet të jetë e kompletuar ashtu si kërkohet, për deri sa në Formularët standard të Dosjes së Tenderit përfshirë deklaratën nën betim dhe dokumentet tjera, kërkohen të dhënat mbi identifikimin e OE, (siç janë: Emri dhe mbiemri, pozita nënshkrimi, data, vula etj) pra kërkohet të plotësohen dhe të nënshkruhen nga përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik (dhe jo nga një person që nuk është kompetent dhe nuk ka autorizim për ta bërë një gjë të tillë). KRPP, konsideron se, nënshkrimi " për" në emër të përfaqësuesit të OE nga një person që nuk ka autorizim për një gjë të tillë, nuk mund të jetë i pranueshëm.

Në lidhje me pretendimin ankimor se AK po ashtu ka shkelur nenin 61 (Tenderit jo-normalisht të ulëta) te LPP-se, sepse e njëjta procedure e tenderimit ka qene e kontraktuar me një OE i cili ka dështuar te përfundoj kontratën me sukses për shkak te çmimeve jo normalisht te ulëta, dhe ka ndërpre kontratën dhe përsëri AK ne projektin e njëjtë e shpërblen një OE me çmime jo normalisht te ulëta. OE Kosova Asfalt ka çmime jo normalisht te ulët te Pahite elastike, ku ky OE ka ofertuar me çmim 9.00 € për metër te pahive, kurse ne kemi ofertuar me çmim 15.00 € pa TVSH, ku dihet se çmimi i një metri pahi elastike është 15.00 €, kurse OE ka ofertuar 9.00 € nen çmim te furnizimit, dhe ky çmim Llogaritet si jo-normalisht i ulet sipas nenit 61 te LPP-se. Pra, AK për çmimet jo-normalisht te ulëta te ofertuar nga OE ankues, duhet te kërkoj sqarime sipas paragrafi 2 te nenit 61 te LPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se eksperti i OSHP-së ka analizuar ofertat e të gjithë pjesëmarrësve/Çmimet për këtë pozicion dhe sqaron se çmimet sillen nga 13,15,16,17,18,20, 21,21,23 ndërsa çmimi i OE të rekomanduarit është 9 euro, gjersa nëse e marrim një mesatare të këtyre çmimeve del çmimi rreth 17,50 euro. AK thuajse për të gjitha ofertat ka kërkuar sqarim në lidhje me çmimet të cilat është menduar që janë të ulëta ose të larta, dhe në rastin konkret për këtë pozicion nuk ka kërkuar, andaj pretendimi ankimor është i bazuar.

Paneli shqyrtues ka shqyrtuar edhe pretendimet ankimore të OE "KEMA COMPANY" SHPK

OE ankues në ankesën e tij ka deklaruar se ne si kompani kërkojmë rivlerësim për këtë vendim për arsye se kemi dorëzuar sqarimin për shume pozicione te cilat janë vlerësuar si çmime jo-normalisht te ulet dhe për te

gjitha ato çmime ne kemi deklaruar ofertat nga disa kompani te cilat furnizohemi me materialet e caktuara, gjithashtu vlen te ceket se gjate sqarimit te çmimeve ne kemi deklaruar ofertat nga kompanitë te cilat ne kemi marrëveshje vjetore për furnizim mirëpo përveç atyre ofertave te deklaruar në sqarime ne posedojmë edhe oferta te tjera për te njëjtat pozicione ku çmimet i kemi te përafërta me një ndryshim mjaft te vogël gjë qe nënkupton se çmimi i ofertuar është çmim brenda tregut, gjithashtu duke u bazuar edhe ne ndryshimet e vogla qe mund te ndodhin gjate kohës ne vijueshmëri.

Nga 10 pozicionet qe kemi pranuar kërkesë për sqarime ne jemi eliminuar duke u bazuar vetëm ne dy pozicione ku pozicioni 3.4 është njeri nga pozicionet qe përfshinë materialin te cilin ne jemi fabrike prodhuese e elementeve te betonit dhe betonit për nevoja te kompanisë pasi qe sasia e kërkuar e betonit ne këtë pozicion ka qen vetëm 25m³ dhe kjo nënkupton se për këtë sasi kompania mund te prodhoj dhe furnizoj gjate punimeve me beton te gatshme nga betonjerka personale ndërsa pozicioni 2.17 është pozicion për te cilin kompania ka deklaruar se ka ne stok një sasi te hekurit prej 10,000kg si dhe ofertat paraprake te pranuar nga disa kompani për këtë pozicion.

Gjithashtu deklarohemi qe kompania është e gatshme qe te pranoj nga Autoriteti Kontraktues rritjen e sigurimit për kryerjen e pozicioneve te caktuar, gjë qe nënkupton qene si kompani jemi dakord qe te shfrytëzohet mundësia me e mire edhe nga AK pra rritja e sigurimit te ekzekutimit ne një vlere te arsyeshme pasi qe janë vetëm dy pozicione te cilat ka dyshime për çmime te ulëta mirëpo nuk e shohim te arsyeshme me vazhdu me eliminim direkt pa ndonjë kërkesë shtesë për te rritur sigurinë dhe besueshmërinë për kryerjen e këtyre pozicioneve.

Paneli shqyrtues pretendimin e OE ankuesit "Kema Company" shpk e konsideron si pjesërisht të bazuar, për arsye se AK ka kërkuar sqarime dhe pasi ka marr sqarimet nga ana e OE ankuesit, ka analizuar arsyetimet dhe ka marr një vendim sipas dispozitave ligjore të LPP-së. Sipas nenit 61 Tenderët Jo-Normalisht të Ulët i LPP-së pika 4: citat "Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin". Paneli shqyrtues sqaron se është në diskrecion të AK-së çështja e çmimeve pasi qe nuk mjafton qe një OE te deklarohet se ka ne stok por ta sqaroj ne mënyrë te detajuar se, si ka ardhur deri tek ai çmim (ekonomicitetin).

Sa i përket pretendimit ankimor lidhur me Certifikatat e Latuesit dhe Armiruesit, paneli shqyrtues konstaton se ky pretendim ankimor i OE ankues nuk ka qenë i parashtruar për arsye se në kërkesën për rishqyrtim tek AK, andaj duke u bazuar në nenin 9. 2 të Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim dhe ankesës në OSHP citat "9.2 Ankesa do të dorëzohet në origjinal tek Organi Shqyrtues i Prokurimit "OSHP" dhe njëkohësisht, një kopje e ankesës do t'i dorëzohet Autoritetit Kontraktues. Pretendimet ankimore duhet te jene te njëjta me ato te paraqitura ne Autoritetin Kontraktues".

Paneli shqyrtues pasi që ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE-ve ankues sqaron se AK nuk ka zhvilluar procedurën e prokurimit konform nenit 59 të LPP-së. Paneli shqyrtues vlerëson se AK gjatë rivlerësimit të ofertave të sigurohet që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së, autoriteti kontraktues po ashtu duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – KK Prishtinë

1x1 OE – “Rahovica Company” SHPK dhe OE “Kema Company” SHPK

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.